



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.353/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Bekim Ibishit, nga Skënderaj, për shkak të mungesë së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Bekim Ibishit, nga Skënderaj, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.353/2017 e datës 23.10.2017, me të cilën ka kërkuar që në të gjitha vendvotimet për Zgjedhjet Lokale 22.10.2017, të shpallen votat e pavlefshme dhe të bëhet rinumërimi i tyre .

A r s y e t i m

PZAP - i me datë 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Bekim Ibishi, nga Skënderaj, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.353/2017; me të cilën ka pretenduar se, në të gjitha vendvotimet ju kanë shpallur votat e pavlefshme, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017. Më tej parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të rinumërohen të gjitha vendvotimet.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pasi që shqyrtoi ankesën, vlerësoi se, pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, se Bekim Ibishit, nga Skënderaj, ju kanë shpallur votat e pavlefshme, janë të pabazuara, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij ankimore.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 115, nenin 117 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 353/2017 me datë 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.